

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 10/ 2026, 10-01-2026****Parashikimi** nga 10-01-2026, ora 12:00 deri 11-01-2026, ora 23:59.**PARASHIKIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET**

Sot pasdite (e shtunë, dt. 10) dhe nesër (e diel, dt. 11) në qarqet Shkodër Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane, në këto qarqe mund të shfaqen probleme me përmbytje të lokalizuara, në varësi të gjëndjes së kanalizimeve.

Sipas llogaritjeve hidrologjike të IGJEO-s, si rezultat i reshjeve të rëna me intensitet të lartë, sot pasdite (e shtunë, dt. 10) dhe nesër (e diel, dt. 11) pritet një rritje e prurjeve dhe niveleve në të gjithë lumenjtë.

Rrezik të shtuar për përmbytje lokale, në vazhdim të ditës së sotme dhe nesër, do të kenë lumenjtë Ishëm, Erzen, Mat, lumi Vjosa. Lumi Drin-Buna dhe Liqeni i Shkodrës do të ketë rritje të prurjeve dhe niveleve dhe rrezik të shtimit të sipërfaqeve të përmbytura në zonën e Nënshkodrës.

DËBORA DHE NGRICA

Sot (e shtunë, dt. 10) dhe nesër (e diel, dt. 11) reshjet e dëborës pritet të përfshijnë zonat në Veri, Lindje dhe Jug Lindje në territorit. Reshjet e dëborës të pasuara nga ulja e ndjeshme e temperaturave dhe ngricat mund të krijojnë probleme të ndryshme dhe vështirësi në transportin rrugor.

PARASHIKIMI METEO**RESHJET**

Sot pasdite (e shtunë, dt. 10) dhe nesër (e diel, dt. 11) priten reshje mesatare deri lokalisht intensive në qarqet Shkodër dhe Elbasan, ndërsa në qarqet e tjerë priten reshje mesatare. Reshjet priten të shoqërohen me shtrëngata (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

Në Veri, Lindje dhe Juglindje në lartësitë mbi 600 m nga niveli i detit reshjet do të jenë në formë dëbore.

TEMPERATURA

Nesër (e diel, dt. 11) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 9 / 10 °C

në vendet e ulëta: 8 / 9 °C

në vendet malore: -2 / 0 °C

ERA

Sot pasdite (e shtunë, dt. 10) dhe nesër (e diel, dt. 11) era pritet të fryjë mesatare deri e fortë në bregdet dhe në zonat malore.

NIVELET E RREZIKUT**S'KA RREZIK****I ULËT****I MODERUAR****I LART**

Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO

Specialist: Indrit Rexhepi

Koordinator: Elona Abazi (Tel: +355 69 311 9392, e-mail: albania.hazards@gmail.com)

faqe 1 / 3

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 10/ 2026, 10-01-2026****Parashikimi** nga 10-01-2026, ora 12:00 deri 11-01-2026, ora 23:59.**PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)**

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
KUKËS	S'KA RREZIK	mesatare					
DIBËR	S'KA RREZIK	mesatare					
LEZHË	S'KA RREZIK	mesatare					
DURRËS	S'KA RREZIK	mesatare					
TIRANË	S'KA RREZIK	mesatare					
ELBASAN	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
FIER	S'KA RREZIK	mesatare					
BERAT	S'KA RREZIK	mesatare					
KORÇË	S'KA RREZIK	mesatare					
VLORË	S'KA RREZIK	mesatare					
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	mesatare					

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 10 / 2026, 10-01-2026****Parashikimi** nga 10-01-2026, ora 12:00 deri 11-01-2026, ora 23:59.**LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe**

Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I ULËT	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I MODERUAR	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
I LARTË	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.

LEGJENDA: Zjarre në pyje

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
ULËT	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
I MODERUAR	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
I LARTË	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT
për sot dhe nesër, dt. 10–11.****SIMBOLE**

	Shtërngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmbytje urbane ose nga përrrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke